

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me pjesëmarjen e bashkëpunëtorit profesional Labinot Jetishi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M., nga Prizreni, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.173-6/17 të datës 28.08.2017, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), pas mbajtjes së shqyrimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Sh. B., të akuzuarit, mbrojtëses së tij-avokates T. Zh., nga Prishtina, me datë 18.04.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

A. M., nga i ati F., e ëma I., me mbiemrin e vajzërisë Z., i lindur me \_\_\_\_\_, në Prizren, rruga \_\_\_\_\_ nr., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, me nr. të letërnjoftimit \_\_\_\_\_; shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

#### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 20.02.2017, rrëth orës 08:30 minuta, në policinë e Kosovës është pranuar një informatë se i dyshuar kishte postuar disa foto në rrjetin social facebook me armë të gjatë, dhe pas realizimit të kontrollit më datë 23.01.2017 rrëth orës 09.30 minuta pikërisht në shtëpinë e të pandehurit është gjetur se i njëjti mbanë në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armën automatike e tipit kallahnikovë AK-47, me numër serik 11121500 si dhe dy karikatorë, ku këtë armë e ka mbajtur në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tillë.

**Kësó dore kryen veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPK-së.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 46, 73, nenin 374 të KPK-së si dhe nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), të akuzuarit i shqipton:

#### DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 700 € (shtatëqind euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë (20) € gjobë, respektivisht 35 (tridhjetë e pesë) ditë burgim.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 të KPK-së, të akuzuarit i shqiptohet edhe

## DËNIMI PLOTËSUES

Konfiskohet arma automatike e tipit kallahnikovë AK-47, me numër serik 11121500 si dhe dy karikatörë.

I akuzuari A M, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 30 euro, që të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën PP/II.nr.173-6/17 të datës 28.08.2017 kundër të akuzuarit A M nga Prizreni, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPK-së.

Gjkata ka mbajtur shqyrtimin fillestar në prezencën e palëve. Është lexuar aktakuza nga prokurori. I akuzuari ka dekluaruar se e ka kuptuar akuzën dhe e pranoj fajësinë për veprën penale që më vihet në barrë dhe provueshmërinë e provave, duke shtuar se i vije keq për veprën që ka kryer dhe në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, shton se është kryefamiljar, mbajtës i familjes, i pa punë, me kushte jo të mira ekonomike dhe kërkon nga Gjkata që ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nuk e ka kundërshtuar.

Në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datë 20.02.2017, rreth orës 08:30 minuta, në policinë e Kosovës është pranuar një informatë se i dyshuar kishte postuar disa foto në rrjetin social facebook me armë të gjatë, dhe pas realizimit të kontrollit më datë 23.01.2017 rreth orës 09.30 minuta pikërisht në shtëpinë e të pandehurit është gjetur se i njëjti mbanë në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armën automatike e tipit kallahnikovë AK-47, me numër serik 11121500 si dhe dy karikatorë, ku këtë armë e ka mbajtur në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla.

Gjkata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari A M, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjkata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojet e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij pas konsultimit me mbrojtësin se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim ka qenë i njostuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të pëershruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka shpreh keqardhje dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të kundërligjshme si dhe qëndrimin e tij korrekt gjatë procesit gjyqësor. Ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësur reziskhmërinë shoqërore të vepërës penale, fenomeni në rritje që është bërë në Kosovë mbajtja e armës, arma ka qenë tipit kallahnikiovë me karikatorë, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se shqiptimi i dënimive të tilla do të ndikojë që i akuzuari të përbahet nga veprimet kundërligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimateve të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 1709/17 të datës 18.04.2018**

**B. Profesional**  
**Labinot Jetishi**

**Gjyqtari**  
**Mehmet Ndrecaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.